

SHOQËRIA TREGTARE
TOP CHANNEL SHA
NIPT K12007002U

VENDIM NR. 2

I

ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE

Sot, më datë 18/07/2017, pranë selisë së shoqërisë në adresën Rruga 17 Nëntori, Godina 20, Kashar, Tiranë, u mbajt mbledhja e thërritur në mënyrë të jashtëzakonshme, me rendin e ditës si vijon:

1. Njoftimi i vendimit të gjykatës nr. 1641, datë 28.06.2017 dhe regjistrimin përkatës pranë QKB;
2. Miratimi i strukturës së re të aksionarëve të shoqërisë për shkak të vendimit të gjykatës nr. 1641, datë 28.06.2017.
3. Të ndryshme.

Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë aksionaret e shoqërisë:


- Znj. Vjollca HOXHA më parë mbajtëse e kapitalit prej 8% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Znj. Lorela HOXHA më parë mbajtëse e kapitalit prej 8% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Znj. Sara HOXHA më parë mbajtëse e kapitalit prej 8% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë;
- Itan HOXHA më parë mbajtëse e kapitalit prej 8% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë, përfaqësuar nga kujdestarja ligjore Znj. Vjollca Hoxha;
- Redia HOXHA më parë mbajtëse e kapitalit prej 8% të aksioneve në kapitalin e shoqërisë.


Aktualisht aksionarët e mësipërm përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë duke e bërë të vlefshme mbajtjen dhe vendim-marrjen e saj.

Aksionarët e mësipërm të shoqërisë kanë qenë në një konflikt gjyqësor me dy prej ish aksionarëve të tjerë që kanë mbajtur aksionet e shoqërisë në masën 60% në bazë të një kontrate e cila në përfundim të gjykimit është shpallur e pavlefshme. Kështu, në bazë të vendimit të gjykatës së Apelit Tiranë me nr. 1641, datë 28.06.2017, është vendosur:

- Ndryshimi i vendimit nr. 3873, datë 09.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në këtë mënyrë:
 1. Detyrimi i të paditurve të njohin paditësit pronarë edhe mbi 60% të aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sha, NIPTI K12007002U, shoqëri e së drejtës shqiptare, për shkak se Kontrata e Shitblerjes së Aksioneve me Nr. 1154Rep. dhe Nr.598/2Kol., datë 15.06.2007, e lidhur përpara noterit Artan Treska, është absolutisht e pavlefshme, pasi është kryer në kundërshtim me ligjin.
 2. Urdhërimin e ç'rregjistrimit nga regjistri i aksionarëve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a të të paditurve Albert Sino dhe Aurel Baçi dhe nga regjistri i ekstraktit të Shoqërisë në QKR, pasi titulli në bazë të të cilit është bërë regjistrimi i tyre në regjistër, është i pavlefshëm.


R. Hoxha
Sara Hoxha





Shpenzimet gjyqësorë në ngarkim të palëve të paditura.
Bashkëlidhur këtij vendimi lëshohet urdhëri i ekzekutimit.


Kjo do të thotë që 60% të aksioneve të shoqërisë të mbajtura më parë nga Z. Albert Sino në masën 40% dhe nga Z. Aurel Baçi në masën 20% kalojnë në favor të trashëgimtarëve të të ndjerit Dritan Hoxha, pra aksionarëve të mësipërm të shoqërisë, të cilët përfitojnë secili në mënyrë të barabartë një të pestën e masës prej 60%. Pra secili prej aksionarëve të mësipërm do të marrë pronësinë e 12% të aksioneve në kapitali duke e çuar secili masën e zotërimit në 20% të kapitalit. Në këto kushte ndryshon dhe struktura e aksionarëve dhe kapitalit të shoqërisë, si më poshtë vijon:

- Znj. Vjollca HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek;
- Znj. Lorela HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek;
- Znj. Sara HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek;
- Itan HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek, përfaqësuar nga kujdestarja ligjore Znj. Vjollca Hoxha;
- Redia HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek.

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, në përfundim të mbledhjes dhe duke mos patur pikë tjetër për të diskutuar dhe vendosur, në mbështetje të statutit dhe të legjislacionit në fuqi,

VENDOSI

1. Njoftimin dhe regjistrimin në bazë të ligjit të Vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 1641, datë 28.06.2017 në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit;
2. Miratimin e strukturës së re të aksionarëve të shoqërisë si vijon:
 - Znj. Vjollca HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek;
 - Znj. Lorela HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek;
 - Znj. Sara HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek;



Shejma Silko Hoxha
Jalisco

- Itan HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek, përfaqësuar nga kujdestarja ligjore Znj. Vjollca Hoxha;
- Redia HOXHA mbajtëse e 20% të kapitalit të shoqërisë TOP CHANNEL SHA, të përbërë nga 1050,8 aksione me vlerë nominale të përgjithshme prej 105.080.000 Lek.

3. Ngarkohet administratori i shoqërisë për depozitimin dhe regjistrimin e këtij vendimi të Asamblesë dhe të Vendimit nr. 1641, datë 28.06.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë në Regjistrin Tregtar pranë QKB si dhe në Qendrën e Regjistrimit të Aksioneve, sipas ligjit.

AKSIONARËT

Vjollca HOXHA

Vjollca Hoxha
[Signature]

Itan HOXHA
kujdestarja ligjore
Vjollca HOXHA

Vjollca Hoxha



Lorela HOXHA

[Signature]
LORELA HOXHA

Sara HOXHA

SARA HOXHA
[Signature]

Redia HOXHA

Redia Hoxha
[Signature]

Vhejmsila Hako
[Signature]